



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 172

Tiranë – E premte, 2 tetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 22.9.2015	Për përbërjen e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë.. 11863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 22.9.2015	Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë..... 11864
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 22.9.2015	Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të programit të certifikimit për profesionistë të shëndetësisë..... 11870
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 22.9.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”..... 11875
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 22.9.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e organit të interesuar, për pagesën e faturave të avokatëve të kontraktuar dhe shpenzimeve administrative të arbitrazhit, për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC, nr. 20564/Emt Hydro, S.R.L., kundër Republikës së Shqipërisë..... 11876
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 22.9.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar Icsid, nr. Arb/14/26, Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni, S.R.L., kundër Republikës së Shqipërisë..... 11876

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 22.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstrukcioni i rrugëve të bllokut nr. 51, në rrugën “Don Bosko”, të Bashkisë së Tiranës.....	11877
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 22.9.2015	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 98, me emërtim “Grup Depo (Ish-Reperti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, për dhënie në përdorim të përkohshëm të disa objekteve e të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	11878



VENDIM
Nr. 787, datë 22.9.2015

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË
PËR PUNË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 39/2, pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Shëndetësisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përbërjes së komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP),

sipas anekseve 1 dhe 2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministri i Shëndetësisë të marrë masa, që, brenda një afati tremujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë kandidaturat alternative për komisionet eprore të caktimit të aftësisë për punë.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1
EMËRTESAT, KANDIDATURAT, FUNKSIONET DHE SPECIALITETET
E KMCAP-ve EPRORE

Nr.	KMCAP	Kandidatura dhe funksioni në KMCAP		Specialiteti
1	Sëmundje të brendshme (Pneumoni /ftiziatri+patologji) (ISSH)	Prof. dr. Perlat Kapisyzi	Kryetar	Pneumolog
2		Dr. Ariana Strakosha	Anëtar	Nefrolog
3		Prof. asc. Teuta Backa	Anëtar	Rheumatolog
4		Prof. asc. Adriana Babameto	Anëtar	Gastrohepatolog
5	Kardiologji (ISSH)	Dr. Mimoza Lezhja	Kryetar	Kardiolog
6		Prof. Artan Goda	Anëtar	Kardiolog
7		Prof. Ali Refatllari	Anëtar	Kardiokirurg
8		Prof. Mihal Tase	Anëtar	Hipertonist-Kardiolog
9	Neurologji (ISSH)	Prof. Jera Kruja	Kryetar	Neurolog
10		Prof. Mira Rakacolli	Anëtar	Neurolog
11		Dr. sh. Altin Kuqo	Anëtar	Neurolog
12		Dr. sh. Artur Xhumari	Anëtar	Neurokirurg
13	Kirurgji (ISSH)	Dr. Astrit Alimehmeti	Kryetar	Onkolog Radioterapeut
14		Dr. sh. M. Dhurata Tarifa	Anëtar	Onkolog
15		Dr. Ibrahim Avdiu	Anëtar	Onkolog-kirurg
16		Dr. Petrika Gjergo	Anëtar	Angiokirurg
17	Ortopedi (ISSH)	Prof. dr. Gjergji Caushi	Kryetar	Ortoped
18		Dr. Fatmir Brahimi	Anëtar	Ortoped
19		Dr. sh. Vilson Ruci	Anëtar	Ortoped
20		Dr. Ilia Mazniku	Anëtar	Ortoped
21	Psikiatri /Okulistikë (ISSH)	Dr. Lefter Sinani	Kryetar	Psikiatër
22		Afrim Dangëllia	Anëtar	Psikiatër
23		Prof. ass. Ali Tonuzi	Anëtar	Okulist
24		Dr. sh. M. Arjeta Grezda	Anëtar	Okulist
25	Sëmundjet e shëndetit mendor (SHSSH)	Dr. Irma Dilaveri	Kryetar	Psikiatër
26		Dr. Ilir Mica	Anëtar	Psikiatër
27		Dr. Klementina Bare	Anëtar	Psikiatër
28		Efigena Kabili	Anëtar	Psikologklinik
29	Sëmundjet e Përgjithshme para moshës 21 vjeç	Prof. ass. Numila Kuneshka	Kryetar	Kardiopediatër
30		Dr. Nevi Pasko	Anëtar	Nefrologe
31		Prof. asc. Thanas Furreraj	Anëtar	Endokrinolog
32		Dr. Aida Bushati	Anëtar	Neuropediatër
33	Verbëri	Dr. Gani Gashi	Kryetar	Okulist



34	(SHSSH)	Dr. Rezarta Shkurti	Anëtar	Okulist
35		Dr. Briken Selimi	Anëtar	Okulist
36		Dr. Shkëlqim Dajti	Anëtar	Okulist për fëmijë
37		Dr. shk. M Perlat Hodo	Kryetar	Neurokirurg
38	Para dhe tetraplegji	Dr. shk. Arsen Seferi	Anëtar	Neurokirurg
39	(SHSSH)	Dr. shk. Artid Lame	Anëtar	Neurokirurg-Elektrofiziolog
40		Dr. shk. M Maksim Basho	Anëtar	Imazherist

ANEKSI NR. 2
EMËRTESTAT, KANDIDATURAT, FUNKSIONET DHE SPECIALITETET
E KMCAP-ve EPRORE

Nr.	KMCAP	Kandidatura I e propozuar	Kandidaturë alternative	Funksioni	Specialiteti
1	Sëmundje të brendshme (Pneumoni/füziatri+patologji) (ISSH)	Sokol Pasho	Leonard Busho	Anëtar	Jurist
2	Kardiologji (ISSH)	Ylli Bedalli	Argita Alikaj	Anëtar	Jurist
3	Neurologji (ISSH)	Enerieta Tarelli	Liljana Kaçi	Anëtar	Jurist
4	Kirurgji (ISSH)	Edlira Bako	Bledar Kabashi	Anëtar	Jurist
5	Ortopedi (ISSH)	Elona Haska	Desantiela Demaj	Anëtar	Jurist
6	Psikiatri okulistikë (ISSH)	Esmeralda Velaj	Ervin Sherifaj	Anëtar	Jurist
7	Sëmundjet e shëndetit mendor (SHSSH)	Diana Stillo	Luan Bozhiqi	Anëtar	Jurist
8	Sëmundjet e përgjithshme para moshës 21 vjeç (SHSSH)	Odetta Fëngjilli	Artan Syziu	Anëtar	Jurist
9	Verbëri (SHSSH)	Bledar Dervishaj	Bledar Kabashi	Anëtar	Jurist
10	Para dhe tetraplegji (SHSSH)	Marsuela Aliaj	Ilir Bejko	Anëtar	Jurist

VENDIM
Nr. 788, datë 22.9.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE
TË PROCESIT TË AKREDITIMIT TË
AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË
VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E
SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Procesi i akreditimit

1.1 Aplikimi për akreditim

1.1.1 Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim, për profesionistët e shëndetësisë, duhet të bëhet në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, këtu e më poshtë “QKEV”, nga ofruesi i aktivitetit, jo më vonë se 30 ditë nga data e planifikuar për zbatimin e tij. Aplikimi për akreditim shoqërohet

me pagesën e një tarife, që varion sipas llojit dhe kohëzgjatjes së aktivitetit, e cila miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, këtu e më poshtë “BEV”.

1.1.2 Për akreditimin e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga QKEV-ja, ofruesi ka detyrimin të dërgojë në QKEV një njoftim me shkrim, të shoqëruar me programin e aktivitetit, të paktën 7 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij.

1.1.3 Për çdo aktivitet të edukimit në vazhdim bëhet një aplikim i veçantë. Përynjatim bëjnë aktivitetet e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor për punonjësit e tyre, për të cilat mund të bëhet një aplikim i vetëm për të gjitha aktivitetet që do të zhvillojë institucioni shëndetësor publik për punonjësit e vet brenda një viti kalendarik. Ky aplikim kryhet në dy faza:

1.1.3.1 Faza e dërgimit të aplikimit për akreditim dhe e programit vjetor të aktiviteteve para zhvillimit të aktivitetit;

1.1.3.2 Faza e plotësimit të materialit didaktik, e cila mund të kryhet dhe pas zhvillimit të aktivitetit.

1.1.4 Procedurat e akreditimit për aktivitetet që institucionet publike kryejnë për punonjësit e vet janë pa pagesë.



1.2 Vlerësimi i brendshëm

1.2.1 Vlerësimi i brendshëm kryhet nga vetë institucioni ofrues i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm. Ai identifikon nevojat për edukim në vazhdim dhe metodat më të mira për përmbushjen e tyre. Të dhënat e ofruara nga aplikuesi duhet të pasqyrojnë me vërtetësi informacione për tre komponentët kryesorë, që janë:

1.2.1.1 Qëllimi dhe objektivat e aktivitetit të edukimit në vazhdim, të cilët paraqiten nëpërmjet një deklaratë të shkruar, duke përfshirë dhe fushat e ndërhyrjes, audiencën, së cilës i drejtohet, llojin e aktivitetit që do të ofrohet dhe rezultatet e pritshme nga ky aktivitet;

1.2.1.2 Planifikimin e aktivitetit, ku ofruesi:

i) duhet të demonstrojë një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit;

ii) duhet të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim;

iii) duhet të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni të tyre para ofrimit të aktivitetit;

iv) duhet të sigurojë përputhje me politikat e parashikuara për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit.

1.2.1.3 Vlerësimin dhe përmirësimin e aktivitetit, ku ofruesi:

i) duhet të ketë parashikuar vlerësimin e efikasitetit të aktivitetit të edukimit në vazhdim në përmbushjen e nevojave të identifikuara paraprakisht;

ii) duhet të bëjë përmirësimet e nevojshme, të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

1.3 Vlerësimi i jashtëm

1.3.1 Vlerësimi i jashtëm kryhet nga QKEV-ja dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit para akreditimit dhe monitorimit të aktivitetit/vlerësimit përfundimtar. Në fazën e parë, që kryhet para se aktiviteti të akreditohet dhe zbatohet, ndiqen procedurat e mëposhtme:

1.3.1.1 QKEV-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe, nëse ai është i plotë, bën vlerësimin e tij sipas kriterëve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e

burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës. Në rast të plotësisimit të pjesshëm nga ofruesit, të dokumentacionit të kërkuar, QKEV-ja ruan të drejtën e refuzimit të akreditimit ose mosvlerësimit me kredite, për ato materiale të programit që kanë mangësi në dokumentacion;

1.3.1.2 QKEV-ja ngarkon një ose më shumë ekspertë të pavarur të fushës, nga lista e përzgjedhur nga BEV-ja, për të kryer vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave që do të përdoren në aktivitet dhe për përputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve. Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti/ekspertët mund të sugjerojnë se cilat tema duhen konsideruar ose jo në llogaritjen e krediteve. Eksperti përgatit raportin përkatës. QKEV-ja paguan ekspertët e pavarur për vlerësimin e kryer prej tyre, bazuar në përcaktimin e orëve të punës, siç paraqiten në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për aktivitete që përdorin materiale trajnuese, të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë ose Organizata Botërore e Shëndetësisë, QKEV-ja mund të mos i kalojë këto materiale për vlerësimin e ekspertit të pavarur të fushës;

1.3.1.3 Bazuar në dy raporte të QKEV-së dhe të ekspertit/ekspertëve, sipas pikave 1.3.1.1 dhe 1.3.1.2 të kësaj pike, QKEV-ja vendos nëse aktiviteti akreditohet ose jo dhe përcakton numrin e krediteve për aktivitetin që do të akreditohet;

1.3.1.4 Dokumentacioni i vlerësimit të brendshëm dhe ai i vlerësimit të jashtëm, së bashku me numrin e përcaktuar të krediteve, bazuar në llojin e aktivitetit dhe kohëzgjatjen e tij, përbëjnë dosjen e vlerësimit, miratimi i së cilës mbyll fazën e parë të procesit të akreditimit. Faza e dytë përshkruhet në pikën 1.5 të këtij vendimi.

1.4 Publikimi i rezultateve dhe përcaktimi i krediteve

1.4.1 Pas vlerësimit të jashtëm, QKEV-ja merr vendimin e akreditimit ose jo të një aktiviteti. QKEV-ja bën të ditur vendimin e saj brenda 30 ditëve, pas plotësisimit të dokumentacionit për akreditim nga ana e ofruesit.

1.4.2 Në rastet kur akreditimi refuzohet, aplikuesit duhet t'i kthehet një përgjigje me shkrim nga QKEV-ja, duke paraqitur arsyet e



refuzimit dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e planifikimit dhe hartimit të propozimeve të ardhshme.

1.4.3 Aktivitetet, të cilat akreditohen, si dhe kreditet përkatëse të tyre, i bëhen të njohura ofruesit dhe publikohen në faqen e internetit të QKEV-së.

1.4.4 Akreditimi i një aktiviteti është i vlefshëm për një periudhë trevjeçare, nga momenti i akreditimit fillestar.

1.5 Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar

1.5.1 QKEV-ja ka të drejtë të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim, të akredituar ose në proces, për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara. QKEV-ja monitoron, në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak, vetëm një pjesë të aktiviteve që akreditohen prej saj. Gjithashtu, QKEV-ja ka të drejtë të realizojë vlerësimin e aktivitetit nga pjesëmarrësit në aktivitet.

1.5.2 Pas përfundimit të aktivitetit, aplikuesi duhet të plotësojë dosjen e vlerësimit, duke dorëzuar pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit.

1.5.3 QKEV-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar apo të rishikojë numrin e krediteve kur vërehen shkeljet e mëposhtme:

1.5.3.1 Ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat cenojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përlllogaritjen e krediteve të miratuara;

1.5.3.2 Mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trajnuesve në aktivitet;

1.5.3.3 Përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose tregtar;

1.5.3.4 Keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe krediteve të njohura prej tij;

1.5.3.5 Mosplotësimi i dosjes me dokumentacionin e nevojshëm për fazën pas aktivitetit;

1.5.3.6 Vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;

1.5.3.7 Shkelje të kritereve të përsëritura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

1.5.4 Në rast të shkeljeve të përsëritura nga ana e ofruesit, ose në rast shkeljesh të rënda, QKEV-ja ka të drejtën të pezullojë ofruesin nga ofrimi i aktiviteve të akredituara të edukimit në vazhdim për një periudhë 6 muaj deri në 1 vit, në varësi të

llojit të shkeljes së vërejtur. Konsiderohen shkelje të rënda: moszhvillimi i aktivitetit të deklaruar, pa njoftim paraprak dhe të motivuar në QKEV, si dhe shkeljet e kritereve për mbështetjen tregtare.

1.5.5 Në rast se gjatë monitorimit të aktivitetit vihet re përmbushje maksimale e standardeve të cilësisë dhe/ose vlerësimi i shkëlqyer i programit, lektorëve/trajnerëve dhe organizimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit, QKEV-ja mund të bëjë një rritje deri në 20% të numrit të krediteve të miratuara paraprakisht për aktivitetin e monitoruar.

1.6 E drejta e ankimit

Ofruesit e aktiviteve të edukimit në vazhdim kanë të drejtë të ankohen pranë QKEV-së, për vendimin e akreditimit dhe numrin e krediteve, brenda 30 ditëve nga momenti i marrjes dijeni të njoftimit. Çdo ankesë duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështetin ankimin. QKEV-ja rishqyrton dosjen e vlerësimit dhe, kur ankesat janë të mbështetura, i reflekton në raportin përfundimtar. Në rastet kur ofruesi nuk është dakord me raportin përfundimtar, ai ka të drejtën e ankimit pranë Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të njoftimit të vendimit nga QKEV-ja.

2. Kriteret e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm

2.1 Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të qëllimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim, e cila duhet të përmbajë të gjithë komponentët bazë (objektivat, fushat që do të përfshijë, llojin e aktivitetit, rezultatet e pritshme), ku rezultatet të jenë formuluar bazuar në termat e ndryshimeve që aktiviteti do të sjellë në njohuritë ose praktikën e profesionistëve ose përfitimin e pacientëve.

2.2 Ofruesi duhet të përcaktojë se cilat nevoja për edukim në vazhdim, të shprehura në njohuri, kompetenca ose praktika, do të adresohen në aktivitetin e propozuar të edukimit në vazhdim.

2.3 Ofruesi duhet të hartojë aktivite, të cilat kanë për qëllim të ndryshojnë njohuritë, aftësitë, performancën ose përfitimet nga ana e pacientëve, të parashikuara në qëllimin e deklaruar të aktivitetit.

2.4 Ofruesi duhet të hartojë aktivite, përmbajtja e të cilave të përputhet me fushën në



të cilën profesionistët pjesëmarrës ushtrojnë profesionin e tyre.

2.5 Ofruesi duhet të zgjedhë forma edukimi (metoda pedagogjike), të cilat janë të përshtatshme për tematikën, objektivat dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit.

2.6 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete që përputhen me tematikën e kompetencave të dëshiruara nga profesionistët (p.sh., udhëzuesit klinikë etj.).

2.7 Ofruesi duhet të organizojë aktivitete të pavarura nga interesat tregtare.

2.8 Ofruesi duhet të menaxhojë, në mënyrë të përshtatshme, mbështetjen (financimin, fondet) tregtare.

2.9 Ofruesi duhet ta mbajë të ndarë promovimin nga pjesa edukative e aktivitetit.

2.10 Ofruesi duhet të promovojë, në mënyrë aktive, përmirësime në shërbimin shëndetësor dhe jo interesat tregtare të ofruesve dhe/ose financuesve të aktivitetit.

2.11 Për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm në distancë, ofruesi:

2.11.1 duhet të deklarojë formatin e nevojshëm për përdorimin e materialit (p.sh., Windows/MacOS; lexues DVD) dhe të ofrojë detaje për kontaktet për ofrim mbështetjeje (teknike) për pjesëmarrësit, në rastin e aktiviteteve që përdorin teknologjinë e informacionit, *hardwar*-in dhe *softwar*-in që nevojitet për të përdorur materialet, dhe instruksione për përfitimin optimal nga kursi;

2.11.2 duhet të deklarojë kohëzgjatjen në orë të kohës që pjesëmarrësit do t'i duhet për të përmbushur objektivat edukativë të aktivitetit;

2.11.3 duhet të ofrojë mbështetje teknike për pjesëmarrësin, në lidhje me ndjekjen e aktivitetit;

2.11.4 duhet të garantojë një mënyrë për konfirmimin e përfshirjes së pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave edukativë;

2.11.5 duhet të respektojë e të konfirmojë konfidencialitetin e pjesëmarrësit, si dhe faktin që çdo informacion, për pjesëmarrësit në aktivitet, do të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij materiali. Rastet e vetme të përjashtimit duhet të jenë me informimin dhe miratimin e plotë të pjesëmarrësit.

2.12 Ofruesi duhet të analizojë ndryshimet te pjesëmarrësit (njohuritë, praktikat ose përfitimet

e pacientëve), të arritura si rezultat i të gjitha aspekteve të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

2.13 Ofruesi duhet të përdorë mjete vlerësuese të procesit të zbatimit të aktivitetit (p.sh., ambienti, kohëzgjatja, numri i temave, burimet e përdorura).

2.14 Ofruesi duhet të identifikojë, planifikojë dhe zbatojë ndryshimet e nevojshme ose të dëshiruara në aktivitet (p.sh., planifikuesit, trajnuesit, infrastrukturën, metodat, burimet, mjetet, ndërhyrjet), që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të ardhshme të edukimit në vazhdim.

2.15 Ofruesi duhet të sigurojë dokumentimin efikas të pjesëmarrësve në aktivitet.

2.16 Për aktivitetet e edukimit në distancë, ofruesi duhet të vërtetojë një përvetësim nga pjesëmarrësit deri në 70% të njohurive të reja, nga ndjekja e aktivitetit të edukimit në distancë (përqindja kaluese).

3. Kriteret për mbështetjen financiare

3.1 QKEV-ja nuk pranon kërkesa për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga subjekte që prodhojnë ose tregtojnë mallra, të cilat përdoren tek ose nga pacientët, të cilët, në kuptim të këtij vendimi, do të konsiderohen palë të interesit tregtar. Këta të fundit, mund të mbështetin financiarisht aktivitete të edukimit në vazhdim vetëm kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

3.1.1 Pavarësia

Ofruesi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim duhet të garantojë se vendimet që do të merren në secilën prej fushave të mëposhtme do të jenë të pavarura dhe nuk do të jenë nën ndikimin e palës së interesit tregtar.

3.1.2 Zgjidhja e konfliktit personal të interesit

3.1.2.1 Ofruesi duhet të jetë i aftë të tregojë se çdo person që mund të ndikojë në përmbajtjen e një aktiviteti edukues ka deklaruar të gjitha lidhjet financiare që paraqesin konflikt interesi për ofruesin e aktivitetit.

3.1.2.2 Individit që do të refuzojë të deklarojë lidhjet e mundshme financiare nuk ka të drejtë të jetë anëtar i komitetit të planifikimit, lektor ose autor i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe nuk mund të ketë kontroll apo përgjegjësi në zhvillimin, menaxhimin, prezantimin ose vlerësimin e aktivitetit.

3.1.2.3 Ofruesi duhet të përfshijë një mekanizëm për të identifikuar dhe për të zgjidhur



të gjitha konfliktet paraprake të interesit të aktivitetit edukues që do të ndjekin pjesëmarrësit.

3.1.3 Përdorimi i duhur i mbështetjes tregtare

3.1.3.1 Ofruesi duhet të marrë të gjitha masat për sigurimin e mbështetjes financiare.

3.1.3.2 Ofruesi nuk duhet të detyrohet nga pala e interesit tregtar për të marrë këshilla apo shërbime që lidhen me lektorët, autorët, pjesëmarrësit apo çështjet e edukimit, përfshirë këtu edhe përmbajtjen, si kusht i marrjes së fondeve.

3.1.3.3 E gjithë mbështetja financiare për aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të menaxhohet vetëm nëpërmjet ofruesit (institucionit që ka bërë kërkesën për akreditim pranë institucionit akreditues).

3.1.3.4 Kushtet dhe qëllimet e mbështetjes tregtare duhet të dokumentohen në një marrëveshje të shkruar, ndërmjet mbështetësit tregtar dhe ofruesit e partnerëve të tij. Marrëveshja duhet të përfshijë edhe ofruesin, nëse mbështetja i është dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë partnerit edukues të ofruesit ose ndonjë sponsori të përbashkët.

3.1.3.5 Marrëveshja e shkruar duhet ta specifikojë palën e interesit tregtar që është burimi i mbështetjes financiare.

3.1.3.6 Mbështetësi financiar, së bashku me ofruesin, duhet të firmosin (nënshkruajnë) marrëveshjen e shkruar ndërmjet të dyve.

3.1.4 Administrimi i duhur i promocionit tregtar

3.1.4.1 Marrëveshjet për prezantimet tregtare ose publiciteti nuk duhet të influencojnë në planifikimin ose në implementimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim dhe as nuk mund të jenë kusht për ofrimin e mbështetjes financiare për aktivitetin.

3.1.4.2 Materialet edukuese, që janë pjesë e një aktiviteti të edukimit në vazhdim, të tilla si: prezantime, konspekte dhe shënime të shtypura, nuk mund të përmbajnë asnjë publicitet, emër tregtar apo mesazh të firmës së prodhimit.

3.1.4.3 Gjatë aktivitetit të edukimit në vazhdim është i ndaluar çdo lloj materiali për promocion të produkteve apo publicitet i produkteve specifike. Duhet të shmanget ballafaqimi dhe krahasimi i produkteve apo subjekteve të ngjashme. Aktivitetet promocionale, gjatë aktiviteteve të drejtpërdrejta

(prova materiale mbështetëse, prezantim) ose publiciteti në materialet elektronike apo të printuara duhet të jenë të ndara nga aktiviteti i edukimit në vazhdim.

3.1.4.4 Në materialet e printuara, publiciteti dhe materialet e promocionit nuk duhet të jenë të përziera me përmbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim.

3.1.4.5 Në prezantimet elektronike, publiciteti dhe materialet e promocionit nuk duhet të jenë të dallueshme në ekran në të njëjtën kohë me përmbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe nuk duhet të shfaqen mes prezantimeve elektronike të përmbajtjes së aktivitetit.

3.1.4.6 Në aktivitetet e drejtpërdrejta, publiciteti dhe materialet e promocionit nuk mund të shfaqen apo të shpërndahen para, gjatë ose pas hapësirës edukative të aktivitetit të edukimit në vazhdim. Ofruesit nuk duhet t'i lejojnë përfaqësuesit e palëve të interesave tregtare të angazhohen në shitje ose aktivitete promocionale gjatë kohës dhe në vendin e zhvillimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

3.1.4.7 Materialet e printuara apo në formë elektronike, të shpërndara mbi elemente që nuk kanë lidhje me informacionin edukativ të aktivitetit, mund të përfshijnë material të promocionit të produktit ose publicitet të produkteve të veçanta.

3.1.4.8 Ofruesi i akredituar nuk duhet të lejojë që pala e interesit tregtar të ofrojë aktivitete të edukimit në vazhdim të pjesëmarrësit.

3.1.5 Përmbajtja dhe formati i paanshmërisë tregtare

3.1.5.1 Përmbajtja apo formati i aktivitetit të edukimit në vazhdim apo materialeve që lidhen me të duhet të përkrahë përmirësimin apo cilësinë në kujdesin shëndetësor dhe jo një firmë ose agjenci të veçantë të regjistruar biznesi.

3.1.5.2 Prezantimet duhet të japin një paraqitje të ekuilibruar të mundësive terapeutike. Përdorimi i emrave të përgjithshëm nuk ndikon anësisht. Nëse në materialin edukues të aktivitetit të edukimit në vazhdim apo gjatë prezantimit të tij përfshihen emra tregtarë, duhet të përdoren emra tregtarë të gatshëm, nga firma të ndryshme, dhe jo vetëm emra tregtarë nga një firmë e vetme.

3.1.6 Deklarimi i lidhjeve financiare

3.1.6.1 Të gjitha lidhjet financiare të mundshme të personave që mund të ndikojnë në aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të deklarohen te



pjesëmarrësit në aktivitetet para se ai të fillojë dhe në formë të shkruar, në programin e aktivitetit ose në faqen zyrtare të ofruesit.

3.1.6.2 Burimi i mbështetjes tregtare duhet të deklarohet, nga ana e ofruesve të aktivitetit të edukimit në vazhdim, të pjesëmarrësit në aktivitetet, para se ai të fillojë. Deklarimi nuk duhet, asnjëherë, të përfshijë përdorimin e emrave tregtarë ose një mesazh promocional.

4. Aktivitete të edukimit në vazhdim dhe kreditet përkatëse

Aktivitetet e edukimit në vazhdim, që akreditohehen nga QKEV-ja, mund të jenë:

4.1 “Konferenca”, një aktivitet 1-3-ditor për një temë të caktuar, zakonisht e zhvilluar nga shoqata profesionistësh, ku mbahen një seri leksionesh nga ekspertë të fushës, e organizuar në seanca plenare dhe/ose seanca paralele. Qëllimi i konferencës është të shtojë njohuritë e audiencës profesionale, kryesisht mbi të rejat e shkencës dhe teknologjisë, në lidhje me praktikën përkatëse shëndetësore;

4.2 “Trajnimi”, një aktivitet edukues (nga 1-ditor deri në 3-mujor), me qëllim përfundimin e njohurive, aftësive dhe shprehive praktike që nevojiten për të përmbushur një detyrë apo punë në mënyrë të kënaqshme. Ai përfshin përdorimin e metodave të ndryshme pedagogjike dhe jo thjesht mbajtjen e leksioneve. Trajnimi mund të zhvillohet larg vendit të punës ose në vendin e punës;

4.3 “Seminari”, një aktivitet mësimor, ku një grup i vogël pjesëmarrësish mësojnë rreth një çështjeje të caktuar dhe marrin pjesë aktivisht, nëpërmjet diskutimit të artikujve të caktuar, prezantimit të studimeve të ndryshme, pyetjeve dhe debateve;

4.4 “Workshop”, një aktiviteti zhvilluar me një grup të vogël pjesëmarrësish, të cilët përfshihen aktivisht në diskutime, zgjidhje problemesh ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi me ndihmën e një eksperti. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë, duke provuar, gabuar dhe korrigjuar vetë ose me ndihmën e të tjerëve, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për praktikën e tyre të përditshme;

4.5 “Prezantimi i një leksioni” - një aktivitet që nxit edukimin në vazhdim profesional. Leksioni është një prezantim me gojë, nga një

profesionist i kualifikuar dhe me përvojë në fushën përkatëse, i një teme të caktuar, të përgatitur mirë, për rreth 20 deri në 40 minuta, i shoqëruar me pyetje-përgjigje. Aftësitë komunikuese, prezantuese dhe ekspertiza janë cilësitë kryesore të një lektori të mirë;

4.6 “Grup rishikimi”, një aktivitet në grup të vogël (5-10), ku profesionistët e të njëjtit specialitet ose shërbim mbledhen për të diskutuar për çështje kryesore që lidhen me praktikën e tyre klinike, me cilësinë e shërbimit dhe zgjidhjet e mundshme. Qëllimi kryesor i grupeve të rishikimit është shkëmbimi i përvojave dhe vlerësimi i punës së njëri-tjetrit, zgjidhja e problemeve praktike, hartimi i udhëzuesve për të përmirësuar shërbimin. Grupet e rishikimit mbledhen rregullisht dhe drejtohen nga një drejtues grupi;

4.7 “Aktivitet kërkimor/studimor”, një pjesë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Përfshirja e profesionistit në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore është një formë tjetër e edukimit në vazhdim. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e mësipërme kryhet sipas kriterit një orë, një kredit, bazuar vetëm në orët reale të mësimdhënies, dhe duke mos përfshirë pushimet mes prezantimeve, seancën prezantuese të aktivitetit etj. Një aktiviteti të drejtpërdrejtë (*live*) të edukimit në vazhdim nuk mund t'i njihen më shumë se 6 kredite në ditë;

4.8 “Aktivitetet e të mësuarit në distancë”, aktivitete edukuese që kryhen në mënyrë të pavarur nga profesionisti, me ndihmën e teknologjisë moderne. Studimi i materialeve të shkruara, videokasetave, videokonferencat, webkonferencat dhe komunikimi nëpërmjet kompjuterit e lejojnë profesionistin të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike në një aktivitet të tillë. Aktivitetet e edukimit në distancë nuk mund të jenë më të gjata se 1–3 ditë dhe mund të vlerësohen, maksimalisht, me 3 kredite në ditë.

5. Ekspertët e pavarur

5.1 Ekspertët që do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim zgjidhen me rotacion, nga lista e ekspertëve të secilës fushë ekspertize, të miratuar nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm. Lista e ekspertëve rishqyrtohet çdo dy vjet.



5.2 Ekspertët e përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim duhet të deklarojnë, para përpilimit të raportit, çdo konflikt të mundshëm interesi me ofruesin e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Gjithashtu, eksperti i përzgjedhur për vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti nuk duhet të jetë i përfshirë në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e aktivitetit që vlerësohet prej tij.

6. QKEV-ja paguan ekspertët e pavarur për vlerësimin e kryer prej tyre, bazuar në përcaktimin e orëve të punës, sipas aneksit 1, bashkëngjitur këtij vendimi.

7. Pagesa e kryer nga ofruesi, gjatë fazës së aplikimit, mbulon shpenzimet operative të QKEV-së gjatë procedurave të vlerësimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe është e

pavarur nga vendimi për miratim ose jo të akreditimit për aktivitetin.

8. Pjesa prej 30 % e të ardhurave të mbledhura nga tarifat për akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim derdhet në buxhetin e QKEV-së dhe përdoret me miratimin e ministrit të Shëndetësisë.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1

VLERËSIMI I ORËVE TË PUNËS PËR EKSPERTËT E PAVARUR

Lloji i aktivitetit	Kohëzgjatja e aktivitetit	Orët e punës së ekspertit	Pagesa për orë pune
Konferenca, trajnime, seminare	½ ditë	4	500 lekë
Konferenca, trajnime, seminare	1 ditë	6	500 lekë
Konferenca, trajnime, seminare	1 ½ ditë	8	500 lekë
Konferenca, trajnime, seminare	2 ditë	10	500 lekë
Konferenca, trajnime, seminare	3 ditë	13	500 lekë
Trajnime	4–6 ditë	16	500 lekë
Trajnime	7–15 ditë	20	500 lekë
Trajnime	16–30 ditë	27	500 lekë
Trajnime	>30 ditë	33	500 lekë

VENDIM

Nr. 789, datë 22.9.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTË TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë ka si qëllim të mbështetë, të fuqizojë dhe të promovojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të shëndetësisë, në mënyrë që ata të ofrojnë një kujdes shëndetësor sa më cilësor për pacientët.

2. Në këtë projektvendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Certifikimi”, procesi që profesionisti i shëndetësisë përfundon me përmbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të shëndetësisë;



b) “Profesionistë shëndetësorë”, personat e pajisur me dijet e nevojshme shkencore dhe profesionale që ushtrojnë profesionin e tyre në fusha dhe profile të ndryshme të sistemit shëndetësor.

II. KRITERET DHE STANDARDET E PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT

1. Profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit

1.1 Profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë: mjekët, stomatologët, farmacistët e ndihmësfarmacistët dhe infermierët e mamitë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ofrojnë shërbime shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore. Nuk përfshihen në program profesionistët që punojnë në administratë.

1.2 Ata profesionistë, të cilët dalin në pension brenda periudhës 4-vjeçare të ciklit dhe që nuk do të vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e tyre në sektorin privat, përjashtohen nga detyrimet e programit të certifikimit për atë cikël.

1.3 Profesionistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit ndërpresin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë, përjashtohen nga kërkesat e programit për atë vit kalendarik.

1.4 Profesionistët të cilët janë në pension dhe ushtrojnë profesionin.

1.5 Profesionistët, të cilët punojnë me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret të programit si ata që ushtrojnë profesionin e tyre me kohë të plotë.

2. Kohëzgjatja e programit të certifikimit

Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë është i organizuar në cikle 4-vjeçare, brenda të cilave profesionistët e shëndetësisë duhet të përmbushin kriteret siç përcaktohen në pikat 3 dhe 4 të këtij kreu.

3. Numri i krediteve të kërkuara

3.1 Brenda një cikli 4-vjeçar, mjekët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 120 kredite të edukimit në vazhdim, stomatologët dhe farmacistët e ndihmësfarmacistët 60 kredite, ndërsa infermierët e mamitë 40 kredite. Numri i nevojshëm i krediteve të edukimit në vazhdim, që një profesionist i përfshirë në programin e

certifikimit duhet të mbledhë sipas kategorive të aktiviteteve, është si më poshtë:

3.1.1 Kreditet e përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim të lidhura drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti;

3.1.2 Kredite të përfituara nga aktivitete të edukimit në distancë duhet të përbëjnë jo më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara.

3.2 Kredite të përfituara nga aktivitete të vetëraportuara të përlogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti.

3.3 Numri vjetor minimal i detyrueshëm i krediteve të edukimit në vazhdim për mjekët është 10 kredite, për farmacistët, ndihmësfarmacistët dhe stomatologët 5 kredite.

3.4 Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e profesionistit, në bazë të nevojave individuale.

3.5 Në fund të ciklit 4-vjeçar të certifikimit, përveç numrit të krediteve të kërkuara, profesionistët duhet të marrin 10 kredite përmes një testi vetëvlerësimi. Ky test kryhet *on-line* dhe lidhet me specialitetin e profesionistit. Ministria e Shëndetësisë harton rregulloren për zhvillimin e testit dhe është përgjegjëse për administrimin e tij.

3.6 Në përmbushje të kriterëve të mësipërme, profesionisti vlerësohet se ka kryer procesin e certifikimit dhe pajiset me vërtetimin përkatës.

4. Standardet e certifikimit

4.1 Profesionisti nxitet ta planifikojë vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit në vazhdim, bazuar në qëllimin e praktikës së tij profesionale, nevojat e identifikuar dhe kompetencat e dëshiruara.

4.2 Profesionisti zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera.

4.3 Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka profesionisti në pozicionin aktual të punës.

4.4 Profesionisti duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, përmes përmirësimit të vazhdueshëm.



4.5 Profesionisti nxitet ta integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupe të kolegëve apo komunitetin e gjerë.

4.6 Profesionistit duhet t'i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet shëndetësore për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

III. PROCEDURA TË PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT

1. Regjistrimi i profesionistëve në programin e certifikimit

Të gjithë profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë përgjegjës për regjistrimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Certifikimit të Profesionistëve që administrohet nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV), si dhe për vërtetësinë e të dhënave të dokumentuara në dosjen e tyre individuale.

2. Njohja dhe regjistrimi i krediteve

3. Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht

3.1 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja. Në rastet kur profesionisti merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet. Regjistrimi i krediteve bëhet nga QKEV-ja në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në një aktivitet të edukimit me kohëzgjatje më pak se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përlllogariten në bazë të kohëzgjatjes së aktivitetit dhe kriterit 1 orë, 2 kredite. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitet me kohëzgjatje më shumë se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përlllogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë x 2 kredite.

3.2 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera, përveç QKEV-së, bëhen pas kërkesës së profesionistit për njohjen dhe regjistrimin e këtyre krediteve në QKEV. Dokumentet që duhet të paraqiten janë: programi i aktivitetit dhe certifikata e ndjekjes

ose diploma e përfituar prej tij me numrin përkatës të krediteve.

4. Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

4.1 Regjistrimi i krediteve nga botimet në revista shkencore, botim i teksteve mësimore, recensimi i botimeve, udhëheqje e oponenca shkencore, ndjekje e praktikave profesionale, stafet profesionale, shkencore në shërbimet klinike të QSUT-së, si dhe postera e abstrakte. Në këtë rast, kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë QKEV-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave, janë fotokopje të kapakut të revistës ose të librit, si dhe fotokopja e faqes së parë të artikullit ose të kapitullit. Në rastet kur profesionisti ka hartuar kurrikula universitare ose pasuniversitare, dokumentet që duhet të paraqiten janë një vërtetim nga fakulteti përkatës dhe një fotokopje e faqes së parë të tyre. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4.2 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga profesionisti pranë QKEV-së. Profesionisti duhet të deklarojë programet e multimedias, të studimit të literaturës profesionale ose vizitat studimore që ka kryer gjatë një viti kalendarik në funksion të përmbushjes së nevojave të tij profesionale, si dhe orët aktive të përfshirjes së tij në këto aktivitete. Përlllogaritja e krediteve për aktivitete të kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Programe universitare të akredituara

Këto programe përfshijnë kurset pasuniversitare me afat të shkurtër, programet e nivelit master dhe programet e doktoraturës (brenda ose jashtë vendit). Konvertimi i krediteve universitare në kredite të edukimit në vazhdim bëhet në bazë të kriterit 1 (një) kredit universitar – 25 (njëzet e pesë) kredite të edukimit në vazhdim.

6. Afatet kohore të regjistrimit të krediteve

6.1 Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të përmendura në nënndarjen 3.1, të pikës 3, të këtij kreu, profesionisti duhet të aplikojë për njohjen dhe për regjistrimin e krediteve pranë QKEV-së para datës 31 dhjetor të vitit kalendarik.

6.2 Për regjistrimin e krediteve të përfituara



nga aktivitete të përmendura në nënndarjen 4.1, të pikës 4, të këtij kreu, profesionisti duhet të plotësojë formularin përkatës, nëse është i nevojshëm, vetëm një herë për secilin vit kalendarik të ciklit, përpara datës 15 dhjetor.

6.3 QKEV-ja duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 60 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.

6.4 I gjithë dokumentacioni i programit të certifikimit duhet të ruhet nga QKEV-ja sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

IV. CERTIFIKIMI I PROFESIONISTËVE

1. Njoftimi mbi statusin e certifikimit

Në fund të secilit cikël 4-vjeçar të programit të certifikimit, QKEV-ja njofton në faqen zyrtare profesionistët për përmbushjen e kërkesave të programit të certifikimit dhe njofton institucionet shëndetësore për statusin e certifikimit të profesionistëve të punësuar në to.

2. Përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore

2.1 Të gjitha institucionet publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë punësuar profesionistë, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre sipas ligjeve në fuqi, kanë përgjegjësi:

2.1.1 Të krijojnë kushte dhe mundësi që profesionistët të përfshihen në aktivitete të edukimit në vazhdim në përputhje me nevojat e pozicionit të tyre të punës;

2.1.2 Të nxitin përfshirjen e profesionistëve në aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe të përfshijnë në kontratat individuale të punësimit kërkesat e programit të certifikimit për profesionistët;

2.1.3 Të hartojnë plane institucionale, njëvjeçare ose shumëvjeçare, të zhvillimit

profesional të punonjësve të tyre, në përputhje me nevojat individuale, por edhe institucionale. Institucionet janë përgjegjëse që të ofrojnë aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e tyre, në mënyrë që ata të mbledhin deri në 30 për qind të numrit total të krediteve të kërkuara përmes këtyre aktiviteteve.

3. Ankimi

Profesionisti ka të drejtë të ankohet pranë QKEV-së për parregullsi në njohjen dhe në regjistrimin e krediteve brenda 30 ditëve nga data e publikimit të rezultateve.

Në rastet kur pretendimet e profesionistit për parregullsinë njohjen dhe regjistrimin e krediteve nga QKEV-ja nuk zgjidhen nga kjo e fundit, atëherë profesionisti ka të drejtë të ankohet pranë Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm brenda 30 ditëve nga data e njoftimit nga QKEV-ja që ankesa e tij nuk është marrë parasysh.

4. Profesionistët e shëndetësisë, të cilët nuk plotësojnë programin e certifikimit sipas përcaktimeve të bëra në këtë projektvendim, i nënshtrohen provimit të certifikimit. Provimi i certifikimit organizohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Ministria e Shëndetësisë, sipas modaliteteve të përcaktuara në rregulloren për organizimin e provimit të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë, e cila miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.

5. Procesi i certifikimit të ndihmësfarmacistëve, infermierëve dhe mamive fillon nga data 1 janar 2016.

V. HYRJA NË FUQI

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKS 1

Lloji i aktivitetit	Nr. i krediteve
Botim artikulli në revistë shkencore	
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe me faktor impakti	10 ¹ –20 ²
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar pa faktor impakti	7–15
Revistë shkencore e paindeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe pa faktor impakti	5–10
Botim i teksteve mësimore	
Tekst pasuniversitar	25 ³ / 50 ⁴
Monografi	50
Tekst mësimor për studentë të UMT	15–30
Recensimi i botimeve (vërtetuar nga Rektorati)	
Recensimi i tekstit	15
Recensimi i artikullit	5
Udhëheqje dhe oponenca shkencore (vërtetuar nga Rektorati)	
Udhëheqje teme masteri shkencor	10
Udhëheqje teme doktorature	5
Oponencë teme doktorature	10
Ndjekje e praktikave profesionale (vërtetuar nga shefi i shërbimit)	
Ndjekje e studentëve nga pedagogu mbikëqyrës	1/10 studentë
Stafet profesionale dhe shkencore në shërbimet klinike të QSUT-së (vërtetuar nga shefi i departamentit)	
Pjesëmarrësi aktiv	10
Pjesëmarrësi pasiv	2
Abstrakt/poster i botuar në librin e përmbledhës të:	
Aktivitet i edukimit në vazhdim jashtë vendit	10–20
Aktivitet i edukimit në vazhdim brenda vendit	5–10

Autori i dytë dhe i fundit¹

Autori i parë²

Autorë të tjerë³

Autori i parë⁴

Limiti. Pavarësisht nga numri i abstrakteve ose posterave të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

ANEKS 2

Lloji i aktivitetit	Numri i krediteve
Lexim artikulli në revistë shkencore	0.5
Lexim libri shkencor	3
Vizitë studimore (>1 javë)	deri në 5*
Pjesëmarrje në aktivitete kërkimore	deri në 5*

Pjesëmarrja në një vizitë studimore të strukturuar, brenda ose jashtë vendit (*observer ship, study tour* etj.), në një institucion shëndetësor publik ose privat, vlerësohet me 0.5 kredite në ditë.

**VENDIM****Nr. 790, datë 22.9.2015****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 299, DATË 8.4.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË
TREGTIMIT TË BARNAVE E TË
KLASIFIKIMIT TË TYRE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 5, e 12, pika 3, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores miratuar me vendimin nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3, e nenit 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Dosja dorëzohet në formatin e dokumentit të përbashkët teknik (*Common Technical Document CTD*) dhe për barnat që gëzojnë statusin “Well Established Medicines” në formatin që ofron mbajtësi i autorizimit të tregtimit. Dokumenti i përbashkët teknik përmban:

a) Modulin 1: Të dhëna administrative dhe informacion mbi barin;

b) Modulin 2: Përmbledhjet e CTD-së;

c) Modulin 3: Cilësia;

ç) Modulin 4: Studimet joklinike;

d) Modulin 5: Studimet klinike.”

2. Në nenin 3, pika 3, dhe në nenin 8, pika 3, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Aplikanti plotëson formularin e aplikimit me të gjitha të dhënat e barit që do të hidhet në treg.”

3. Në nenin 3, ndarja “A”, shkronja “b” dhe në të gjithë përmbajtjen e rregullores, pas fjalëve “... kopje me vulë apostile në vendin përkatës, e vlefshme në momentin e aplikimit...” shtohen “... ose kopje e legalizuar në vendin përkatës ...”.

4. Në pikën 9, të nenit 5, fjalët “... brenda 6 muajve ...”, zëvendësohen me “... brenda 15 muajve ...”.

5. Pika 1 e nenit 10, riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Krahas aplikimit për rinovimin e autorizimit të tregtimit, aplikanti duhet të paraqesë seksionet e mëposhtme të modulit 2:

a) Raportin e ekspertit për cilësinë;

b) Raportin e ekspertëve për dokumentacionin joklinik, nëse është i aplikueshëm në vendin referent;

c) Raportin e ekspertit për dokumentacionin klinik, nëse është i aplikueshëm në vendin referent.”

6. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Pas daljes së urdhrimit të ministrit të Shëndetësisë, agjencia, brenda 10 (dhjetë) ditëve, njofton zyrtarisht aplikantin për rinovimin e autorizimit për tregtim, për barin, si dhe për tarifën përkatëse që do të paguhet.”

b) Pika 8 shfuqizohet.

7. Pas shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 14, shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) Në një gjuhë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në latine.”

8. Në kapitullin IX, “Dispozita të përgjithshme mbi ndryshimet (variacionet)”, te klasifikimi i ndryshimeve, te dokumentacioni për çdo ndryshim që kërkohet, fjalët “miratim në vendin referencë” zëvendësohen me “miratimin nga Agjencia e vendit referent për ... nëse ky miratim është i aplikueshëm në vendin referent”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 791, datë 22.9.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ENERGJISË DHE
INDUSTRIË, NË CILËSINË E
ORGANIT TË INTERESUAR, PËR
PAGESËN E FATURAVE TË
AVOKATËVE TË KONTRAKTUAR DHE
SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË
ARBITRAZHIT, PËR PËRFAQËSIMIN
DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E
ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ICC,
NR. 20564/EMT HYDRO, S.R.L.,
KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e organit të interesuar, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 220 000.00 (dyqind e njëzet mijë) USD, për pagesën e shpenzimeve administrative të arbitrazhit, dhe kundërvlera në lekë e fondit prej 200 000.00 (dyqind mijë) eurosh, për kryerjen e pagesave të faturave të avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC, nr. 20564/EMT Hydro, S.R.L., kundër Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kontratës për ofrimin e shërbimeve ligjore, datë 17.3.2015.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 792, datë 22.9.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E MJEDISIT, PËR
PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE
PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN
NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR ICSID, NR.
ARB/14/26, ALBANIABEG AMBIENT,
SHPK, M. ANGELO NOVELLI DHE
COSTRUZIONI, S.R.L., KUNDËR
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t'i shtohet fondi prej 39 050 000 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë mijë) lekësh, për kryerjen e pagesës së tarifave të avokatëve të kontraktuar për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID, nr. ARB/14/26, Albaniabeg Ambient, sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni, S.R.L., kundër Republikës së Shqipërisë, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet (ICSID).

2. Fondi prej 39 050 000 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë mijë) lekësh, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 793, datë 22.9.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE TË
BLOKUT NR. 51, NË RRUGËN “DON
BOSKO”, TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve të bllokut nr. 51, në rrugën “Don Bosko”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 6 244,2 (gjashtëmijë e dyqind e

dyzet e katër presje dy) m², në vlerën 223 311 324,60 (dyqind e njëzet e tre milionë e treqind e njëmbëdhjetëmijë e treqind e njëzet e katër presje gjashtëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 223 311 324,60 (dyqind e njëzet e tre milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e katër presje gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë “truall”, prej 6 244,2 (gjashtëmijë e dyqind e dyzet e katër presje dy) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR
RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËVE TË BLOKUT NR. 51, RRUGA “DON BOSKO”**

Nr.	Emër, mbiemër	Z. kadas.	Nr. i pas.	Truall	Çmimi	Objekt	Çmimi (m ²)	Vlera/lekë
1	Bashkëpronarët Ferro	8330	9/371	774	35.763	0	0	27,680,562
2	Bashkëpronarët Gjoka	8330	9/762	1761	35.763	0	0	62,978,643
3	Bashkëpronarët Bardhoshi	8330	9/286	795	35.763	0	0	28,431,585
4	Bashkëpronarët Bardhoshi	8330	9/415	786	35.763	0	0	28,109,718
5	Asllan Çiba	8330	9/510	36	35.763	0	0	1,287,468
6	Bashkëpronarët Karaj	8330	9/447	1707	35.763	0	0	61,047,441
7	Bashkëpronarët Karaj	8330	9/448	385,2	35.763	0	0	13,775,907.60
				6244,2 m²			SHUMA	223,311,324.60 lekë



VENDIM

Nr. 796, datë 22.9.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE MINISTERIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIM “GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM “INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM KETA”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTERISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësive së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 98, me emërtim “Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-

vjeçare, të disa objekteve, si dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 931,2 (pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një presje dy) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për vendosjen e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për plotësimin e nevojave institucionale të këtij institucioni.

2. Prona nr. 98, me emërtim “Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, sipas planvendosjeve, t’i tjetërsojnë ato apo t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



Plan-Vendosja e Prones nr.98 Brar, Tirane


Sistemi i koordinatave shtetërore





PLAN VENDOSJA E REP. USHT. 7030, Prona nr.6
 pjesa që do t'i jepet në përdorim Ministrisë së Drejtësisë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

SISTEMI I KOORDINATAVE SHETERORE



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë